

## Skemat e Lirimit dhe Kthimit për të Burgosurit me Shtetësi të Huaj - Fletë me fakte

Kjo fletë me fakte shpjegon disa nga skemat e lirimit dhe të kthimit që ekzistojnë për të burgosurit me shtetësi të huaj. Ajo është hartuar për t'ju dhënë informacion bazë rreth secilës skemë. Për informacion më të hollësishëm duhet të flisni me një anëtar të personelit të burgut ose agjencive të tjera, që kanë informacion rreth çështjeve të shtetasve të huaj.

Edhe nëse nuk largoheni ose dëboheni nën njërin nga këto skema më poshtë, përsëri mund të dëboheni pas mbarimit të dënimit tuaj.

### Skema e Lirimit të Hershëm

Skema e Lirimit të Hershëm (ERS) është një skemë që lejon të burgosurit që janë shtetas të huaj (FNP) të dëbohen nga Mbretëria e Bashkuar përpara se të mbarojë dënimi i tyre.

- Çdo FNP që vuan një dënim duhet të konsiderohet për ERS.
- Burgu do të dërgojë informacion rreth FNP-ve te Ministria e Brendshme, që do të vendosë nëse një i burgosur do të lirohet nën ERS.
- ERS lejon një FNP të dëbohet nga MB-ja deri 270 ditë përpara se të jetë mbushur gjysma e dënimit të tyre, nëse ata kanë vuajtur të paktën çerekun e dënimit të tyre të plotë.
- Për shkak se ERS-ja është një skemë vullnetare ata që e kundërshtojnë dënimin nuk mund të dëbohen nën këtë skemë.
- FNP-të që nuk kualifikohen për ERS-në përfshijnë:
  - ata që vuajnë një dënim për një shkelje të mëparshme të kushteve të lirimit (p.sh. Lirimi me Licencë të Përkohshme, Ndalimi në shtëpi);
  - të burgosurit që nuk kanë paguar një gjobë ose nuk kanë zbatuar një urdhër konfiskimi;
  - të burgosurit që kur dënohen kanë më pak se 14 ditë të mbetura përpara gjysmës së dënimit të tyre.
- Shërbimi i burgut mundet, që në rrethana të jashtëzakonshme, të refuzojë lirimin nën ERS. Shembuj të këtyre rrethanave përfshijnë provat e qarta se FNP synon të kryejë shkelje të tjera penale, shet-blen drogë të klasit A në burg, ka prova të dhunës ose kërcënimeve me dhunë në disa raste në burg ose vuan dënim për terrorizëm ose shkelje terrorizmi.
- Nëse dëboheni nga MB-ja nën ERS, mund të riarrestoheni dhe të dërgoheni sërish në burg nëse ktheheni në MB përpara se të ketë mbaruar dënimi juaj.
- Edhe pasi dënimi juaj të ketë mbaruar do të jeni subjekt i një kufizimi për të hyrë në MB për të paktën 5 vjet. Pasi të ketë mbaruar kufizimi mund të aplikoni të ktheheni në MB, por ka shumë mundësi, që aplikimi të refuzohet për shkak të precedentëve penalë.

- Të burgosurit mund të ankohen rreth refuzimit për t'u liruar nën ERS duke përdorur sistemin e ankesave të Shërbimit të Burgut.
- Një i burgosur mund ta tërheqë ERS-në në çdo fazë të procesit.

Më shumë informacion rreth ERS-së mund të gjenden në Udhëzimet e Shërbimit të Burgut 04/2013.

## Skema e Largimit pas Mbarimit të Kohës së Detyruar

Skema e Largimit pas Mbarimit të Kohës së Detyruar (TERS) lejon largimin e të Burgosurve që janë Shtetas të Huaj, të cilët vuajnë një Dënim të pacaktuar ose të përjetshëm (IFNP) pas mbarimit të kohës së tyre të detyruar, ose sa më parë pas kësaj kohe.

- Të gjithë IFNP-të që kualifikohen për largimin do të konsiderohen për skemën nga Seksioni i Çështjeve të Mbrojtjes Publike në Shërbimin e Menaxhimit të Shtetasve të huaj (NOMS).
- TERS është një skemë vullnetare, ndaj ata që e kundërshtojnë dënimin nuk mund të dëbohen nën këtë skemë.
- IFNP-të që mund të konsiderohen si të papërshtatshëm për lirim nën TERS mund të përfshijnë:
  - Një IFNP që përballet me akt-akuza të tjera penale ose është subjekt i një urdhri konfiskimi ose procedurave të tjera të konfiskimit. Mund të konsiderohen përjashtime për shembull, nëse një i burgosur ka vuajtur një periudhë të detyrueshme të gjatë dhe sasia e parave që duhet të shlyejë është relativisht e vogël.
  - Ka prova të qarta që IFNP po planifikon shkelje të tjera penale.
  - Ata që vuajnë dënime për terrorizëm ose shkelje që kanë lidhje me terrorizmin.

Më shumë informacion rreth TERS-it gjendet në Udhëzimet e Shërbimit të burgut 18/2012.

## Skema e Kthimeve të Lehtësuara

Skema e Kthimeve të Lehtësuara (FRS) është një skemë vullnetare që iu jep ndihmë financiare atyre që kthehen në atdhe.

- FRS-ja ju ofrohet vetëm FNP-ve që NUK janë nga Zona Ekonomike Evropiane (EEA).
- Skema punon me ERS-të, në mënyrë që ata që janë pranuar në skemë të kthehen në atdhe deri 270 ditë përpara gjysmës së dënimit të tyre.
- Skema ofron një sasi parash dhe mbështetje ristrehimi për çdo FNP që pranon të kthehet në atdhe dhe heq dorë nga e drejta e apelimit të dënimit.

Shkelësit e mëposhtëm që janë shtetas të huaj (FNO) NUK do të kualifikohen për FRS-në:

- Çdo FNO që vuan një dënim prej 4 ose më shumë vjet
- Çdo FNO që ka aplikuar më parë për FRS-në dy herë dhe më pas e ka tërhequr aplikimin
- Çdo FNO që ka apeluar vendimin e dëbimit më lartë se Tribunali i Shkallës së Parë të Imigracionit dhe Dhomës së Azilit përfshi rishikimet gjyqësore. Mund t'ju duhet të pyesni avokatin, nëse kjo gjë zbatohet për ju.

Çfarë merrni nën FRS-në	Nëse vuani dënim me burg	Nëse e keni kryer dënimin tuaj me burg
Kur largoheni nga MB-ja	£500	£500
Kur të jeni kthyer në atdheun tuaj	£1000	£250

- Prindërit e vetëm mund të marrin një shumë shtesë prej £100 për secilin fëmijë, që kthehet me ta. Kjo do të vendoset në kartën tuaj të të hollave me £500, kur ju të largoheni.
- Paratë do të vendosen në një kartë të hollash. £500 do t'ju jepen në aeroport që të merren kur të ktheni në atdhe dhe pjesa e mbetur do të futet në kartë një muaj pasi të ktheheni në atdheun tuaj.
- Nëse dëboheni nën FRS-në, autoritetet në shtetin tuaj NUK do të informohen që ju keni marrë para nga skema.
- Nëse ndryshoni mendje mund të largoheni nga skema në çdo kohë.
- Mund të aplikoni duke i kërkuar ndihmë një anëtar të personelit të burgut ose duke telefonuar ekipin e FRS-së në Ministrinë e Brendshme në numrin 020 8760 8513.
- Largimi nën FRS-në llogaritet si dënim gjë e cila do të thotë se nuk ju lejohet të hyni sërish në MB gjatë periudhës së urdhrin të dëbimit, zakonisht një minimum prej 5 vjetësh. Edhe pasi ky kufizim të ketë mbaruar çdo aplikim për të hyrë në MB mund të refuzohet bazuar mbi precedentët penalë dhe karakterin e keq.

## Transferimi i të burgosurve

Nëse ka një marrëveshje ndërmjet shtetit tuaj dhe MB-së atëherë ju mund të aplikoni që të vuani dënimin tuaj në atdheun tuaj. Kjo njihet si transferim i të burgosurve.

Zakonisht, që një i burgosur të transferohet në shtetin e tyre nën një marrëveshje të transferimit të të burgosurve, duhet që i burgosuri të shprehë dëshirën të transferohet. Megjithatë, tani ekzistojnë marrëveshje me disa shtete evropiane, të cilat lejojnë që një i burgosur të transferohet te një burg në shtetin e tyre pa pëlqimin e tyre. Nëse jeni njoftuar nga Ministria e Brendshme se po përpiqet t'ju transferojë te një burg në shtetin tuaj dhe nuk doni të largoheni, duhet të kërkonti këshilla ligjore për zgjedhjet që keni.

- Një listë e të gjitha shteteve që kanë një marrëveshje për transferimin e të burgosurve me MB gjendet në Udhëzimet e Shërbimit të Burgut 52/2011, së bashku me formularin e aplikimit për transferim vullnetar.
- Nuk do të liroheni pas kthimit në shtetin tuaj, por thjeshtë do të vuani pjesën e mbetur të dënimit tuaj atje.
- Nëse doni të ktheheni në mënyrë vullnetare te një burg në shtetin tuaj duhet të dini se është një proces i ngadaltë, që zakonisht zgjat 6 muaj dhe zakonisht nuk ja vlen të aplikoni nëse dënimi juaj është 4 vjet ose më shumë dhe keni të paktën 6 muaj për të vuajtur.